



REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITARDREJTORIA
RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR TIRANË
ZYRA VENDORE ARSIMORE RROGOZHINË

Rrogozhinë, më 27.01.2025

NJOFTIM

**PËR
KUALIFIKIMIN E MËSUESVE PËR VITIN SHKOLLOR 2024-2025**

Në zbatim të nenit 59 të ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe udhëzimit nr. 17, datë 22.07.2024, "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve", ju informojmë se:

Mësuesit që dëshirojnë të kualifikohen duhet të aplikojnë në platformën SMIP brenda datës **31 janar 2025**, duke plotësuar rubrikat përkatëse.

Mësuesit e arsimit parashkollor duhet të dorëzojnë në Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP) kërkesën për pjesëmarrje në kualifikim deri më datë **31 janar 2025**.

Pas miratimit të kërkesës nga ZVA, mësuesit duhet të dorëzojnë dosjen profesionale brenda datës **7 shkurt 2025**.

KRITERET E PRANIMIT PËR KATEGORITË E KUALIFIKIMIT

Kandidatët për kualifikim (kandidatët) janë punonjës të institucioneve arsimore parauniversitare publike dhe private, të cilët zotërojnë diplomë në fushën e mësuesisë ose diplomë të arsimit të lartë të ciklit të parë dhe të dytë ose të barasvlershme me to, të ngjashme ose të përafërt me fushën përkatëse të mësimdhënies në arsimin parauniversitar. Gjithashtu, përfshihen kandidatët që japin lëndët e muzikës, arteve pamore dhe edukimit fizik.

Procedurave të kualifikimit u nënshtrohen detyrimisht të gjithë mësuesit të cilët, deri më **31 dhjetor të vitit paraardhës**, plotësojnë kushtet e mëposhtme për vjetërsinë e punës në arsim:

Kushtet për vjetërsi pune në arsim për kategoritë e kualifikimit:

"Mësues i Kualifikuar"

- 3 vite punë si mësues.
- 30 kredite për zhvillim profesional për tre vite.
- Vlerësim i performancës nga drejtori i shkollës: **Mire** ose **Shumë mirë**.

"Mësues Specialist"

- 8 vite punë si mësues, nga të cilat 5 vite pas fitimit të kategorisë "Mësues i Kualifikuar".
- 50 kredite për zhvillim profesional për pesë vite.
- Vlerësim i performancës nga drejtori i shkollës: **Mire** ose **Shumë mirë**.

"Mësues Mjeshtër"

- 15 vite punë si mësues, nga të cilat 7 vite pas fitimit të kategorisë "Mësues

Specialist”.

b) 70 kredite për zhvillim profesional për shtatë vite.

c) Vlerësim i performancës nga drejtori i shkollës: **Shumë mirë**.

Punonjësit arsimorë që kanë mospërputhje midis vjetërsisë së punës dhe kategorisë së kualifikimit kualifikohen për kategorinë më të ulët që nuk e kanë fituar ende.

DOSJA PROFESIONALE E KANDIDATIT

Dosja e kandidatit duhet të përmbajë fotokopje të dokumenteve të mëposhtme, të cilat duhet të jenë autentike dhe të vërtetuara me origjinalet:

a) Jetëshkrim (me fotografi) ;

b) Fotokopje e kartës së identitetit ;

c) Formulari i aplikimit ;

d) Diploma e arsimit të lartë sipas kërkesave të kualifikimit ;

e) Certifikatat me kreditet përkatëse të vlefshme ;

f) Dëshmi për mbrojtjen e gjuhëve të huaja (nëse ka) ;

g) Vlerësimi i fundit nga drejtori i shkollës ;

f) Fotokopje e librezës së punës ;

Shënim: Kandidatët që nuk dorëzojnë dokumentet e kërkuara sipas pikave (e) dhe (g) nuk do të marrin pjesë në procesin e kualifikimit.

DORËZIMI I DOKUMENTACIONIT

Dokumentacioni dorëzohet në rrugë postare në adresën:

Zyra Vendore Arsimore Rrogozhinë

Bashkëlidhur: Formulari i aplikimit.